



Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија  
Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së  
Veriut

04.01.2021

**NJOFTIM**

**Lëshimi i udhëzimit laboratorik UL 1 – COVID 19 nga mjeku i zgjedhur**

Në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 303/2020, u botua Vendim për ndryshim të Vendimit për përcaktimin e formularëve të parashikuar në Rregullore për Përmbajtjen dhe Mënyrën e Ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, me të cilin prezentohet formulari i ri i Udhëzimit laboratorik 1 - COVID-19- (SARS-CoV-2) - "UL1 – COVID - 19". Në Vendim u bë korrigjim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 311/2020, me të cilin është botuar edhe formulari i këtij udhëzimi, që është i nevojshëm të zbatohet në praktikë.

Me Udhëzimin laboratorik 1 - COVID-19- (SARS-CoV-2) - "UL1-COVID-19", i mundësohet mjekut të zgjedhur nga fusha e mjekësisë së përgjithshme, për arsye të monitorimit të gjendjes shëndetësore të personave të siguruar të sëmurë me COVID 19 të cilët janë në trajtim shtëpiak, të jetë në gjendje të lëshojë udhëzim të tillë UL 1 – COVID - 19 për përcaktimin e vlerave të shërbimeve shëndetësore laboratorike biokimike: D-Dimer dhe CRP

**Udhëzimi mund të realizohet në të gjitha institucionet shëndetësore publike (spitalet dhe qendrat shëndetësore) dhe institucionet shëndetësore private që kanë marrëveshje me Fondin për këtë lloj shërbimi shëndetësor.**

Me respekt,